



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

Nr. 223 , datë 11.04.2012

“Për

përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshem motorrik ndaj paleve te treta (TPL)

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Rezana KONOMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.04.2012 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përcaktimi i hapave të kryerjes së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL).

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të Vendimit 222, datë 11.04.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL)”

V E N D O S I:

I. Përcaktimin e fazave të kryerjes së hetimit të thelluar si më poshtë vijon:

- a) Inspektime në ndërmarrjet nën hetim;
- b) Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
- c) Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;

ç) Hartimi i Raportit të Ndërmjetëm brenda dy muajve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi.

d) Diskutim i Raportit të Ndërmjetëm në Komision;

dh) Hartimi i Raportit Përfundimtar të Hetimit të Thelluar dhe paraqitja e tij përpara Komisionit brenda 15 diteve nga diskutimi ne Komision I Raportit te Ndermjetem.

II. Sekretari i Përgjithshëm të miratojë matricën e veprimeve të hetimit të thelluar sipas hapave të përcaktuar më sipër në këtë vendim.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R